



BASHKIA BERAT
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. _____ Prot.

Berat, më ____/____/202__

RAPORT VJETOR PËR DËGJESAT PUBLIKE PËR VITIN 2022

Procesi i njoftimit dhe i konsultimit publik në Bashkinë Berat gjatë vitit 2022 është bazuar në parimet e mëposhtme:

- a) *transparencë gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik*
- b) *pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese;*
- c) *efektshmëri e procesit të vendimmarrjes në organet publike;*
- d) *përgjegjësia e organeve publike ndaj palëve të interesuara.*

Procesi është realizuar në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 18, Ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, dhe Ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Bashkia (Ekzekutivi) dhe Këshilli Bashkiak kanë bashkërenduar me qëllim realizimin e një procesi konsultimi efikas duke optimizuar burimet në dispozicion. Gjatë vitit 2022, janë realizuar dëgjesa me banorë në qytetin e Beratit në kuadër të hartimit të buxhetit 2023 dhe PBA 2023-2025 dhe 1 prej këtyre dëgjësave është dokumentuar edhe në platformën konsultimivendor.al në faqen dedikuar bashkisë Berat brenda kësaj platforme, në të cilën kjo bashki ishte një ndër shtatë bashkitë pilot të përzgjedhura nga UNDP / STAR 3.

Gjate vitit 2022, Bashkia Berat bashkëpunoi me Projektin STAR 3, përmes Qendrës për Çështje të Informimit Publik,(INFOÇIP), për të rritur vizibilitetin e procesit të konsultimit publik si dhe për konsolidimin e një modeli që mund t’u shërbejë edhe bashkive të tjera të vendit.

Ky Raport Vjetor është hartuar nga Bashkia Berat në zbatim të detyrimeve që cakton për autoritetin publik neni 20 i Ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Sipas parashikimeve të këtij neni, organet publike hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes, ku përfshihet informacion për:

- a) *numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues;*
- b) *numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;*

c) numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit;
ç) numrin e takimeve publike të organizuara.

➤ **Numri i akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit 2022.**

Këshilli Bashkiak Berat miratoi gjithsej 103 vendime gjatë vitit 2022¹ të cilat gjendet të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet si dhe në platformën e centralizuar VENDIME.AL, në të cilën ato gjithashtu publikohen konform standartit të unifikuar të publikimit.

➤ **Numri i përgjithshëm i rekomandimeve të marra nga palët e interesuara:**

Gjatë procesit konsultativ u regjistruan gjithsej 3 rekomandime konkrete.

➤ **Numri i rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara:**

Nga 3 rekomandime, u mbajtën parasysh 2 dhe 1 u kthyen me motivim të arsyetuar nga zyrtarët publikë që u angazhuan në organizimin/drejtimin e dëgjësive.

➤ **Numri i takimeve publike të organizuara:**

1. Datë 02.11.2022 / Bashkia Berat zhvilloi dëgjësë publike me të rinj e të reja me temë “Buxheti Vendor për rininë për vitin 2023 dhe prioritetet e investimit në Bashkinë Berat” (Asistuar nga INFOCIP / STAR 3)

Bashkia Berat njoftoi në datën 22.10.2022, nëpërmjet njoftimit zyrtar, zhvillimin e dëgjësës me të rinj e të reja për buxhetin 2023 dhe prioritetet e investimit në Bashkinë Berat. Takimi u zhvillua në datën 02.11.2022 pranë ambjenteve të Qendrës Multifunkionale Rinore në orën 11:00 dhe përfundoi në orën 13:00. Pjesëmarrës në këtë takim ishin; Kryetari i Bashkisë Berat Z.Ervin Demo, Drejtoresha e Qendrës Multifunkionale Rinore Berat znj.Fitore Sulejmani, Drejtues të Shkollave të qytetit të Beratit dhe rreth 60 të rinj e të reja. Në këtë takim të rinjtë u njohën në mënyrë të detajuar me të drejtat dhe garancitë që i ofron ligji nr.75/2019 “Për Rininë” dhe më pas paraqitën idetë, kërkesat dhe sugjerimet e tyre.

Tre kërkesat kryesore që u propozuan nga të rinjtë në këtë konsultim ishin:

1. Ndërtimi i Klubit të Robotikës dhe Informatikës me qëllim që nxënësit e prirur drejt kësaj fushe të kishin mundësi zhvillimin e njohurive të tyre.
2. Krijimi i një skuadre basketbolli me emrin “Tomori” duke qënë se shumë të rinj të talentuar në këtë fushë kishin dëshirë për ta përfaqësuar shkollën e tyre më së miri.

¹ Shiko vendimet e Bashkisë Berat: <https://www.vendime.al/category/berat/2022-berat/>

3. Të bëhej e mundur ekzistenca e aboneve për nxënësit, duke pretenduar që në qytetet e tjera të vendit një gjë e tillë funksionon.

Kryetari i Bashkisë u bëri me dije të rinjve se dy kërkesat e para të listuara më lart do të realizohen.

Ky takim u mbështet dhe u lehtësua nga Qendra për Cështjet e Informimit Publik (INFOCIP) dhe nga Drejtori i saj ekzekutiv z.Gerti Shella, në kuadër të projektit “Promoting Public Consultations and Participation at Local Level”, mbështetur nga STAR 3/UNDP².

I gjithë procesi i këtij konsultimi u shoqërua me procesverbal³, konform parshikimeve ligjore të Ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin publik”, si edhe në audio-video dhe foto⁴, konform parimit të transparencës me publikun.

Bashkia Berat ishte e ndër të parat bashki në këtë proces konsultimesh që organizoi konsultim publik vecanerisht me Këshillin Vendor Rinor dhe me të rinjtë e tjerë të qytetit në kuadër të hartimit të buxhetit dhe PBA 2023-2025, duke lënë të kuptohet që zëri i të rinjve ka rol të rëndësishëm në procesin vendimmarrës të pushtetit lokal.

Konceptoi / Hartoi:

Koordinatorë Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik
Bashkia Berat

² Kliko linkun: <https://konsultimivendor.al/bashkia-berat-degjese-tematike-me-te-rinj-dhe-te-reja-buxheti-vendor-per-rinine-2023-dhe-prioritetet-e-investimit-ne-bashkine-berat/>

³ Shih Procesverbalin e konsultimit: <https://konsultimivendor.al/procesverbal-i-degjeses-date-02-nentor-2022-qendra-multifunkionale-rinore-berat/>

⁴ Shih degjese e dokumentuar nw audio-video dhe foto: <https://konsultimivendor.al/bashkia-berat-degjese-publike-per-buxhetin-2023-me-keshillin-vendor-rinor/>